Në bazë të nenit 39 paragrafi (3) të Ligjit për Mësimdhënësit dhe Bashkëpunëtorët Profesionalë në Shkollat Fillore dhe të Mesme („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19), ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE
për ndryshimin e Rregullores për normativin e bashkëpunëtorëve profesionalë në arsimin fillor, përkatësisht në arsimin e mesëm

Neni 1

Në Rregulloren për normativin e llojit të arsimit të bashkëpunëtorëve profesionalë në arsimin fillor, përkatësisht në arsimin e mesëm, nr. 18-14026/1, të datës 18.11.2022, dhe nr. 18-9524/4, të datës 23.07.2026, neni 7 ndryshohet dhe thotë:

„Bashkëpunëtor profesional – bibliotekist në arsimin fillor dhe të mesëm mund të jetë personi:

- bibliotekist i diplomuar, me së paku 240 kredi të fituara sipas sistemit SETK ose shkallën VII/1, përkatësisht nivelin VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë, të cilat korrespondojnë me nivelin VI të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë.,
- me studime përkatëse në fakultet me drejtim arsimor, me së paku 240 kredi të fituara sipas sistemit SETK ose shkallën VII/1, përkatësisht nivelin VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë, të cilat korrespondojnë me nivelin VI të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë,
- me arsim të lartë përkatës, në përputhje me normativat e programeve mësimore, me së paku 240 kredi të fituara sipas sistemit SETK ose shkallën VII/1, përkatësisht nivelin VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë, të cilat korrespondojnë me nivelin VI të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë, si dhe me përgatitje të fituar pedagogjiko-psikologjike dhe metodike në institucion të akreditуar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ose
- me arsim të lartë në fushën e gjuhëve, me së paku 240 kredi të fituara sipas sistemit SETK ose shkallën VII/1, përkatësisht nivelin VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë, të cilat korrespondojnë me nivelin VI të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë, si dhe me përgatitje të fituar pedagogjiko-psikologjike dhe metodike në institucion të akreditуar nga Ministria ."

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e sjelljës së saj.

Министерка за образование и наука,
проф. д-р Весна Јаневска, с.р.

Nr. 18-13777/2
Data 05.11.2026